

Bibël për fëmijët  
paraqet

Perëndia  
Provon  
Dashurinë e  
Abrahamit



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Byron Unger; Lazarus  
Alastair P.

Adaptuar nga: M. Maillot; Tammy S.

Përkthyer nga: Arianit Iljazi

Prodhuar nga: Bible for Children  
[www.M1914.org](http://www.M1914.org)


©2020 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta  
shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.



Një natë  
Perëndia i dha  
Abrahamit një  
urdhër te  
çuditshëm.



An illustration of an elderly man with white hair and a beard, wearing an orange robe with a white sash, standing in profile and looking out at a night landscape. The landscape features rolling green hills, a dark green field with grey rocks, and a large white moon in a dark purple sky with several yellow stars. The scene is framed by grey curtains on the left.

Ishte një provë  
për të parë nëse  
Abrahami donte  
birin e tij Isakun,  
më shumë se

Perëndinë.



“Merre birin tënd Isakun,  
dhe ofroje atë  
si një ofertë  
të djegur”,  
urdhëroi  
Perëndia.



Të ofronte Isakun? Të sakrifikonte birin e tij? Kjo ishte e vështirë për Abrahamin.



Ai e donte birin  
e tij shumë.



Por Abrahami  
kishte mësuar ti  
bindej Perëndisë  
edhe kur nuk kuptonte.





Në mëngjes ai u nis për në malin e sakrificës me Isakun dhe dy shërbëtorë.



Përpara se të niseshin,  
Abrahami preu drutë në  
copa për të bërë  
një zjarr për  
ofertën e djegur.



Abrahami  
kishte bërë  
në plan ti  
bindej  
Perëndisë.





Tre ditë më vonë  
ata iu afruan malit.  
"Qëndroni këtu", i  
tha Abrahami

shërbëtorëve  
të tij.



"Ne do të shkojmë  
të adhurojmë,

dhe do të  
vijmë prap  
tek ju".



Isaku mbante  
drutë; Abrahami  
mbante zjarrin,

dhe një  
thikë.



Isaku pyeti "Ku është  
qengji për sakrificën  
e djegur"?



"Perëndia, do të  
parashikojë Ai vetë  
një qengj", u përgjigj  
Abrahami.





Të dy erdhën  
pikërisht tek vendi  
i duhur, zgjedhur  
nga Perëndia.



Atje, Abrahami ndërtoi  
një altar dhe rregulloi  
drutë për të djegur  
sakrificën përpara  
Perëndisë.



Abrahami kishte ndërtuar shumë altarë. Me siguri, ky ishte më i vështiri nga të gjithë për tu ndërtuar.



Abrahami e lidhi Isakun,  
dhe e vendosi në altar  
birin e tij të dashur.



A me të vërtetë do të bindej  
Abrahami, dhe do ta sakrifikonte  
birin e tij të dashur,  
birin e tij të vetëm?





Po! Tehu  
i thikës  
vezulloi  
ndërsa  
Abrahami e  
ngriti lart.



Zemra  
e tij mund  
të ishte duke  
u bërë copa,  
por Abrahami  
e dinte se ai  
duhej ti bindej  
Perëndisë.



"Ndal"!  
thirri  
Engjëlli i  
Zotit.





"Tani  
Unë e di  
që ti i  
bindesh  
Perëndisë.





Ti nuk  
kurseve  
as birin  
tënd, birin  
tënd të  
vetëm,  
për  
mua."



Duke parë një dash në  
shkurre, Abrahami e  
zgjidhi Isakun, dhe  
sakrifikoi dashin  
në vend të  
tij.



Mbase Isaku mendonte,  
"Perëndia parashikoi,  
pikërisht si babi  
im tha".



Ndërsa atë e bir adhuronin,  
Engjëlli i Zotit i foli Abrahamit.

"Në fëmijët e tu të gjitha  
kombet do të bekohen,  
sepse ti u  
binde".



Një ditë Jezusi do të lindej nga pasardhësit e Abrahamit.



Abrahami dhe Isaku u kthyen  
në shtëpi. Ca kohë më vonë,  
trishtimi pllakosi.





Sara vdiq. Abrahami kishte humbur  
gruan e tij, dhe Isaku nënën e tij.





Pas varrimit,  
Abrahami dërgoi  
kryeshërbëtorin e tij,  
për të parë për një nuse për  
sakun.



Shërbëtori  
shkoi në  
vendlindjen e tyre, ...



... për të  
gjetur një  
nuse në farefisën e  
Abrahamit.



Shërbëtori i kërkoi Perëndisë një shenjë. "Ajo vajzë që do të ofrojë ujë edhe për devetë e mia, le të jetë ajo e duhura për Isakun."



Menjëherë Rebeka ofroi tu japë  
ujë. Ajo ishte një nga kushërirat  
e Abrahamit.



Shërbëtori e dinte se Perëndia i  
ishite përgjigjur lutjes së tij.



Rebeka la familjen e saj për tu  
martuar me Isakun.



Ajo e ngushëlloi atë pas vdekjes së  
nënës së tij. O sa shumë e  
donte



Isaku,  
Rebekën.





Perëndia Provon Dashurinë e Abrahamit

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Zanafilla 22-24

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u  
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.



Nëse ti beson se kjo është e  
vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:  
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i  
bërë njeri për të vdekur për mëkatet e mia,  
dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem, eja në  
jetën time dhe fal mëkatet e mia, në mënyrë  
që unë të kem jetë të re dhe një ditë të jem  
me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo, të të bindem  
dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë  
çdo ditë! Gjoni 3:16

